

**Lënda:** Përgjigje shkresës suaj Nr.44/2 Prot. datë 07.02.2018 “Kërkohet informacion”.

**Drejtuar:** **Z. Petrit AHMETI** ✓  
Kryetar i Bordit të Komisionerëve të ERE

**TIRANË**

I Nderuar z. Ahmeti,

Në përgjigje shkresës suaj Nr.44/2 Prot. datë 07.02.2018 “Kërkohet informacion” informojmë se:

1. Përgjigje për shkresën tuaj nr. 44 datë 12.01.2018 është dërguar me shkresën tonë Nr. 762/1 Prot. datë 25.01.2018, megjithatë bashkëngjitur do të gjeni sërish përgjigjen që ju kemi kthyer.
2. Më poshtë informacion në përgjigje për shkresën tuaj Nr. 59 datë 12.01.2018 lidhur me problematikën e pagesave ndaj KESH dhe OST :

Megjithë vështirësitë e krijuara OSHEE në zbatim të Planit të Rimëkëmbjes miratuar me VKM 171 datë 25.02.2017 ka përbushur dhe tejkalar ndjeshëm planin e pagesave ndaj KESH dhe OST për çdo vit dhe në total si në tabelën që vijon:

000/Lekë

Viti	Detyrimi %	KESH				OST			
		Faturuar	Detyrimi	Paguar	%	Faturuar	Detyrimi	Paguar	%
2015	85%	15,626,334	13,282,384	15,515,348	99%	4,749,437	4,037,021	5,720,847	120%
2016	95%	12,715,070	12,079,317	12,715,070	100%	4,570,338	4,341,821	4,436,905	97%
2017	95%	5,595,424	5,315,653	5,721,668	102%	4,831,961	4,590,363	4,727,722	98%
<b>Total</b>		<b>33,936,829</b>	<b>30,677,354</b>	<b>33,952,086</b>	<b>100%</b>	<b>14,151,736</b>	<b>12,969,205</b>	<b>14,885,474</b>	<b>105%</b>
<b>Paguar më shumë se detyrimi</b>				<b>3,274,732</b>		<b>1,916,268</b>			
<b>Paguar më shumë se faturimi</b>				<b>15,257</b>		<b>733,738</b>			

Ecuria e pagesave për çdo muaj gjatë vitit 2017 për KESH paraqitet në tabelën që vijon:

000/Lekë

Përshkrim	Jan'17	Shku'17	Mar'17	Prill'17	Maj'17	Qer'17	Korr'17	Gush'17	Shta'17	Tet'17	Nen'17	Dhje'17	Total
Faturimi	773,625	783,000	539,400	574,200	600,300	304,500	643,800	236,640	84,893	241,458	479,852	333,756	5,595,424
Detyrimi 95%	734,944	743,850	512,430	545,490	570,285	289,275	611,610	224,808	80,648	229,385	455,859	317,069	5,315,653
Pagesa	773,625	783,000	539,400	591,600	582,900	304,500	643,800	236,640	84,893	361,458	350,000	469,852	5,721,668
Pagesa %	100%	100%	100%	103%	97%	100%	100%	100%	100%	150%	73%	141%	102%

Ecuria e pagesave për çdo muaj gjatë vitit 2017 për KESH paraqitet në tabelën që vijon:

000/Lekë

Përshkrim	Jan'17	Shku'17	Mar'17	Prill'17	Maj'17	Qer'17	Korr'17	Gush'17	Shta'17	Tet'17	Nen'17	Dhje'17	Total
Faturimi	511,423	540,102	407,531	386,340	350,437	340,008	360,570	404,597	417,117	343,156	366,453	404,227	4,831,961
Detyrimi 95%	485,851	513,097	387,154	367,023	332,915	323,007	342,542	384,367	396,261	325,999	348,131	384,016	4,590,363
Pagesa	407,184	540,102	407,531	386,340	350,437	340,008	360,570	404,597	417,117	343,156	366,453	404,227	4,727,722
Pagesa %	80%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	98%

Sikundër në tabelë OSHEE ka paguar ndaj KESH gjatë vitit 2017 rreth **406 milion Lekë** më shumë se detyrimi sipas Planit të Rimëkëmbjes (95% të faturimit) dhe ka paguar ndaj OST rreth **137 milion Lekë** më shumë se sa detyrimi sipas Planit të Rimëkëmbjes (95% të faturimit) duke përbulluar në të njëjtën kohë të gjitha detyrimet e pagesave shtese si pasojë rritjes së shpenzimeve të blerjes së enegjisë për faktorët e përmendur më lart.

Pasqyra e Rrjedhjes së Parave (Cash Flow) do tju dërgohet sapo të mbyllet Pasqyrat Financiare të vitit 2017.

Ju kujtomë se kërkesave tuaja lidhur me pagesat ndaj KESH dhe OST ju jemi pergjigjur vazhdimisht duke theksuar se kemi përmbushur dhe tejkualuar në vazhdimësi planin e pagesave sikundër është detajuar në Planin e Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë Elektrike sipas VKM nr.171 datë 25.02.2015. Theksojmë gjithashtu se të gjithë informacionin e kërkuar e kanë edhe KESH dhe OST dhe kërkesa e tyre drejtuar ndaj jush na duket e pakuptimtë.

Me konsideratë,

**Adrian CELA**  
Administrator

**OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A**

Protokoll



Nr. 2621 Prot.

Tiranë, më 25/01/2018

**Drejtuar:** **Z Petrit AHMETI**  
**Kryetar i Bordit të Komisionerëve të ERE**

**TIRANË**

**Lënda:** Përgjigje shkresës Nr.44 date 12.01.2018 “Kërkesë për plotësim dokumentacioni lidhur me aplikimin për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit për vitin 2018”

**I nderuar z.Ahmeti,**

Më poshtë përgjigje shkresës suaj Nr.44 date 12.01.2018 “Kërkesë për plotësim dokumentacioni lidhur me aplikimin për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit për vitin 2018”, për sejcilën pikë sipas renditjes suaj:

1. Aplikimi tëplotësohet me analiza të detajuara dhe argumentat përkatese për të gjitha shpenzimet operative për vitin ushtrimor të mbyllur dhe të audituar (2016) dhe shpenzimet e pritshme për vitin 2017. Gjithashtu analiza e realizimit të të ardhurave të kërkuara për vitet 2015-2017 duhet të krahasohet me të ardhurat e miratuara dhe diferencat të reflektohen në të ardhurat e kërkuara për vitin 2018. Kjo në zbatim të pikës 5 të Vendimit Nr.190, datë 22.12.2016 të Bordit të ERE-s, e cila përcakton se: *Përditësimi dhe kompensimi i të gjitha efekteve të mundshme financiare për të licensuarit për periudhën 2015 dhe vitin 2016 dotëbëhet në periudhën pasardhëse sipas përcaktimeve të nenit 20 germa "c", të Ligjit Nr. 4312015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"*

Krahasimi i të ardhurës së kërkuar që duhet të realizohet sipas rezultateve financiare të periudhës 2015 – 2017 dhe kompensimi që duhet mbartur për vitin 2018 detajohen në tabelën që vijon:

a) Për Operatorin e Shpërndarjes:

Zëri	2015 ERE	2015	2016	2017	2018
<b>Shpenzime Operative</b>	<b>7,882,657</b>	<b>7,246,995</b>	<b>9,584,366</b>	<b>9,491,819</b>	<b>9,542,800</b>
Kosto e transmetimit për humbjet	787,028	1,243,776	1,075,454	1,058,828	1,045,654
Kosto e humbjeve	9,323,257	13,035,606	7,922,131	14,408,503	8,905,662
<b>Total OPEX</b>	<b>17,992,942</b>	<b>21,526,377</b>	<b>18,581,950</b>	<b>24,959,150</b>	<b>19,494,116</b>
Vlera e asetëve në v. 2011	29,243,289	35,502,006	35,502,006	35,502,006	35,502,006
Vlera e investimeve në v. 2012	765,883	765,883	765,883	765,883	765,883
Vlera e investimeve në v. 2013	448,508	448,465	448,465	448,465	448,465
Vlera e investimeve në v. 2014	1,234,953	1,208,133	1,208,133	1,208,133	1,208,133
Vlera e investimeve në v. 2015	2,783,734	1,626,099	1,626,099	1,626,099	1,626,099
Vlera e investimeve në v. 2016	-	-	7,130,056	7,130,056	7,130,056
Vlera e investimeve që priten në v. 2017	-	-	-	12,116,267	12,116,267
Vlera e investimeve që priten në v. 2018 (1/2)	-	-	-	-	6,250,135
minus: Amortizimi i akumuluar	(22,417,253)	(20,639,702)	(22,475,007)	(25,088,696)	(29,254,074)
vlera e RAB pa kapitalin e punës	<b>12,059,116</b>	<b>18,910,884</b>	<b>24,205,635</b>	<b>33,708,213</b>	<b>35,792,970</b>
Kapitali i punës 1/4	<b>1,499,412</b>	<b>5,381,594</b>	<b>4,645,488</b>	<b>6,239,787</b>	<b>4,873,529</b>
<b>RAB</b>	<b>13,558,528</b>	<b>24,292,478</b>	<b>28,851,123</b>	<b>39,948,000</b>	<b>40,666,499</b>
Norma e interesit të borxhit të vjetër	0.85%	0.83%	1.32%	1.23%	1.19%
Norma e interesit të borxhit të ri	3.35%	3.80%	3.57%	3.63%	2.01%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	16.44%	16.44%	16.44%	16.44%	16.44%
Borxhi i vjetër %	30.95%	32.56%	34.31%	42.96%	29.73%
Borxhi i ri %	29.05%	27.44%	25.69%	17.04%	30.27%
Raport i synuar i kapitalit të vet	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%
Kthim për borxhin e vjetër	0.26%	0.27%	0.45%	0.53%	0.35%
Kthim për borxhin e ri	0.97%	1.04%	0.92%	0.62%	0.61%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%
<b>WACC</b>	<b>7.81%</b>	<b>7.89%</b>	<b>7.95%</b>	<b>7.72%</b>	<b>7.54%</b>
<b>Fitimi</b>	<b>1,059,144</b>	<b>1,916,783</b>	<b>2,292,956</b>	<b>3,085,144</b>	<b>3,066,061</b>
Amortizimi i vitit	3,330,521	2,079,534	2,678,027	2,400,000	2,958,096
Të ardhura nga lidhjet e reja	(399,114)	(645,104)	(540,865)	(654,852)	(375,677)
Të ardhurat nga energjia reaktive	(252,770)	(316,594)	(318,132)	(329,043)	(355,938)
<b>Totali i të Ardhurave të Kërkuara</b>	<b>21,730,721</b>	<b>24,560,996</b>	<b>22,693,937</b>	<b>29,460,399</b>	<b>24,786,658</b>
Energji e lëvruar në rrjetin e shpërndarjes MWH	4,544,000	4,459,444	4,605,265	4,789,590	4,803,209
<b>Tarifa mesatare e shpërndarjes Lekë/KW</b>	<b>4.78</b>	<b>5.51</b>	<b>4.93</b>	<b>6.15</b>	<b>5.16</b>
Diferenca e tarifës në fakt me atë të miratuar		0.73	0.15	1.37	
<b>Vlera për tu kompensuar (Akumulative) 000/Lekë</b>		<b>3,234,645</b>	<b>3,904,876</b>	<b>10,460,072</b>	<b>10,460,072</b>



b) Për Operatorin e Shitjes:

Zeri	2015 ERE	2015	2016	2017	2018
<b>Shpenzime Operative</b>	<b>2,064,819</b>	<b>1,898,311</b>	<b>2,510,572</b>	<b>2,486,330</b>	<b>2,499,684</b>
Kosto e Energjisë së shitur nga FPSH (+Marzh)	13,632,000	13,378,333	13,815,794	19,421,534	16,841,325
Kosto e transmetimit	2,953,600	2,725,012	2,760,035	3,013,587	3,311,237
Marzhi	299,904	294,323	298,003	971,077	842,066
Kompensimi i Borxhit të Keq	4,496,883	3,709,373	3,857,845	1,252,715	3,169,725
Kompensim për humbjet 2012 - 2014 (CEZ)	3,442,872	3,051,308	2,894,742	2,787,638	2,818,842
<b>Totali i të Ardhurave të Kërkuara</b>	<b>26,890,079</b>	<b>25,056,659</b>	<b>26,136,990</b>	<b>29,932,882</b>	<b>29,482,879</b>
Energji e shitur në rrjetin e shpërndarjes MWH	4,544,000	4,459,444	4,605,265	4,789,590	4,803,209
<b>Tarifa mesatare e shitjes Lekw/KW</b>	<b>5.92</b>	<b>5.62</b>	<b>5.68</b>	<b>6.25</b>	<b>6.14</b>
Diferenca e tarifës në fakt me atë të miratuar		(0.30)	(0.24)	0.33	

<b>Vlera për tu kompensuar (Akumulative)</b>		<b>(1,333,043)</b>	<b>(2,448,677)</b>	<b>(859,204)</b>	<b>(859,204)</b>
--	--	--------------------	--------------------	------------------	------------------

Vlera totale për tu kompensuar në tarifën e vitit 2018 është paraqitet në tabelën që vijon:

Vlera për tu kompensuar (Akumulative) 000/Lekë	2015	2016	2017	Gjithsej
Vlera për tu kompensuar në Shpërndarje	3,234,645	3,904,876	10,460,072	10,460,072
Vlera për tu kompensuar Shitje	(1,333,043)	(2,448,677)	(859,204)	(859,204)
<b>Vlera për tu kompensuar Gjithsej</b>	<b>1,901,602</b>	<b>1,456,198</b>	<b>9,600,869</b>	<b>9,600,869</b>

Analiza financiare të detajuara për vitin 2016 do të gjeni në dokumentin e Pasqyrave Financiare 2016 (të audituara) dërguar me shkresën Nr. 21869 date 27.09.2017. Një analizë e hollësishme për shpenzimet e vitit 2017 (e pritëshme) dhe parashikimi për 2018 gjendet në dokumentin e tarifës faqe 55 – 61, ju lutem specifikoni kërkesën për informacione të detajuara.

2. Kostot operative të propozuara për vitin 2018 duhet të shoqërohen me një analizë të detajuar dhe të argumentuar, konform dispozitave 7.2 e 7.3 të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike".

Në studimin për tarifën janë analizuar në mënyrë të detajuar shpenzimet e planifikuara për vitin 2018, analiza më të hollësishme për vitin 2018 do të gjeni në dokumentin bashkëngjitur të Planit Financiar 2018 miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës të OSHEE Nr. 67 datë 27.12.2017.

3. Për argumentin e të ardhurave të kërkuara për vitin 2018, aplikimi duhet të shoqërohet edhe me Programin Ekonomik e Financiar të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës për vitin 2018.

Bashkëngjitur do të gjeni dokumentin miratimit të Planit Financiar 2018 nga Këshilli Mbikqyrës të OSHEE Nr. 67 datë 27.12.2017.



4. Lidhur me Bilancin Energjitik për vitin 2018 konstatohet mungesë rakordimi me parashikimet e bëra nga OST sh.a., për sa i takon parashikimit të energjisë së prodhuar nga KESH sh.a. ashtu edhe parashikimit të prodhimit nga PPE dhe PVE. Lutemi konfirmoni sasi të propozuara me OST sh.a.

Vlera e sasisë së furnizimit të pritshëm për KESH për vitin 2018 është përcaktuar në vendimin Nr. 3924/1 datë 26.12.2017 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë bashkëngjitur. Parashikimi i prodhimit nga PPE dhe PVE nuk përmban vetëm sasinë e energjisë së kaluar nga HEC-et nëpërmjet OST, por edhe atë të HEC-ve lidhur drejtpërdrejt në rrjetin e OSHEE.

5. Të paraqiten argumenta në lidhje me cmimin prej 8,267 lekë/kWh për energjinë e blerë në tregun e parregulluar për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

Çmimi mesatar i sipërpërmendur është rezultat i analizës si vijon:

Për periudhën Janar 2018-Shtator 2018 i jemi referuar cmimeve të kostos së blerjes së energjisë nga tregu i pa rregulluar për këtë periudhë për vitin 2017, ndërsa për periudhën Tetor –Dhjetor 2018 i jemi referuar cmimit mesatar të kësaj periudhe shumëzuar me një koeficient që perfaqson trendin e cmimeve të ketyre muajve krahasuar me pjesën tjetër të vitit.

6. Parashikimi për blerjen nga KESH sh.a. të sasisë 537 GWh me cmirin 1,5 Lekë/kWh për mbulimin e humbjeve bie në kundërshtim me dispoziten 5.4 të VKM 244, datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" në të cilën përcaktohet se "Sasia e tepert e energjisë elektrike, e krijuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, pas përmbushjes së kërkesës së klienteve që përfitojnë nga furnizimi universal, .... i shitet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për mbulimin e humbjeve" dhe dispozitën 3.3.b të VKM 729, datë 08.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.244, datë 30.03.2017" e cila në vijim të dispozitës së sipërpërmendur 5.4 shton pikën 4,1 sipas së cilës sasia e mbetur e energjisë elektrike pas plotesimit të nevojave në përputhje me sa më lart, KESH e tregon sipas parimeve të një tregu të lirë dhe konkurrues, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara, bazuar në rregulloren për tregtimin e energjisë elektrike, që miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Lutemi të reflektoni këto kërkesa ligjore në llogaritjet tuaja duke bërë të ditur efektin në rezultatin përfundimtar.

Sasia dhe çmimi i furnizimit të pritshëm për KESH për vitin 2018 është përcaktuar në vendimin Nr. 3924/1 datë 26.12.2017 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkëngjitur.

7. Përsa i përket llogaritjes së RAB, nga shqyrtimi paraprak i tabelave shoqëruese të aplikimit vërehet një diferencë prej 5,908 milion Lekë midis vlerës bruto të aseteve në datën 31.12.2012 në aplikimin e OSHEE dhe asaj të miratuar nga ERE me vendimet përkatëse. Lutemi, paraqisni shpjegimet tuaja.

Sipas Bilancit verifikues nga CEZ Shpërndarje në Pasqyrat e audituara të vitit 2012 gjendja analitike në llogaritë e aseteve është si në tabelën që vijon:

Përshkrimi	Vlera
Të tjera AAGJ - JM	73,046,642
Software	26,820,432
Toka	1,030,908,742
Përmirësimi i Tokave	755,061,660
Ndërtesa dhe Konstruksione	2,831,669,378
Makineri dhe Pajisje	30,482,209,908
Mjete Transporti	364,775,277
Pajisje Zyre	157,174,284
Pajisje IT	546,222,993
<b>GJITHSEJ</b>	<b>36,267,889,316</b>

Nuk ka diferencë në përlogaritje.

8. Në lidhje me kërkesën për llogaritjen e kapitalit të punës sa 1/4 e shpenzimeve operative duhet të paraqisni studim të plote mbi fondet e nevojshme për të mbajtur një nivel të përshtatshëm të materialeve, furnizimeve dhe parave të nevojshme rezervë, për të përbushur detyrimet korrente dhe për të mbajtur llogaritë minimale ashtu sikurse përcaktohet në dispozitën 8.9 të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike".

Sikundër është theksuar në studimin e tarifës:

"Vlera e kapitalit të punës për shkak të detyrimeve tejet të larta të kompanisë është negativ. Në ndryshim nga periudhat para vitit 2015 OSHEE ka detyrimin e pagesave për detyrime të prapambetura sikurse përcaktohen në Planin e Rimëkëmbjes së Sektorit Energjitik për të cilat ngurtëson një pjesë të Arkëttimeve në llogaritë bankare gjatë vitit. Mbi këtë bazë, Kapitali i punës, për efekt të tarifës është përlogaritur sipas Metodologjisë së Tarifës së Shpërndarjes duke pasur parasysh faktorët si vijon:

1. Vlera minimale e kapitalit të punës do të ishte sa 1/12 e shpenzimeve operative OPEX dhe bazuar në planin e shpenzimeve operative prej 12,968 milion Lekë duhet të jetë 1,080 milion Lekë.
2. Vlera minimale e ngurtësuar në llogaritë e OSHEE për shlyerje të detyrimeve ndaj CEZ është 2,819 milion Lekë. Llogaritë e ngurtësuar të OSHEE lidhen edhe me detyrime ndaj Bankës Botërore, KESH dhe OST.
3. Vlera minimale e Kapitalit të Punës në OSHEE duhet të jetë rreth 4 miliard Lekë.

Bazuar më lart në përlogaritjet për Tarifën 2018 vlera e Kapitalit të Punës është marrë sa ¼ e Shpenzimeve Operative ose 25%."



Vlera minimale e propozuar  $\frac{1}{4}$  e Opex për kapitalin e punës sa më lart përbëhet nga:

- a)  $\frac{1}{12}$  e OPEX = 1.1 miliard Lekë e cila është parashikuar rreth 13 miliard Lekë për vitin 2018,
- b) Vlera e 2.9 miliard Lekë që duhet të jetë në llogaritë e ngurtësuar të OSHEE për shlyerjen e detyrimeve ndaj CEZ, KESH dhe OST. Për KESH dhe OST vlera e pagesave të kryera është gjithmonë më e lartë se sa vlera vjetore e faturuar duke paguar edhe pjesë nga detyrimet e prapambetura, për vitin 2017 pagesa ka qenë 2% më e lartë.

9. Lidhur me parashikimin nga ana juaj të "kthimit të lejuar mbi kapitalin" në nivelin 16.44% në perputhje me pikën 4.2. të Deklaratës Rregullatore, ju rikujtojmë se efektet e kësaj deklarate shtrihen deri me 31.12.2014 e për rrjedhojë i ka kaluar aktualiteti. Lutemi paraqisni propozimin tuaj për një normë të arsyeshme të kthimit mbi kapitalin e vet të argumentuar në perputhje me dispozitën 8.11 të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjise elektrike".

Megjithë përmirësimin e jashtëzakonshëm të performancës në periudhën 2015 – 2017 ku kapitali i OSHEE është përmirësuar me rreth 35 miliard Lekë ai mbetet sërish negativ ose rreth – 36 miliard Lekë, gjë që tregon që OSHEE dhe investimi në rrjetin e shpërndarjes në Shqipëri mbetet akoma një biznes me risk shumë të lartë.

Studimi në zbatim të Metodologjisë së Llogaritjes së Tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike neni 7 Kërkesa për të Ardhura për Vitin Bazë (Kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve) pika 11 bëhet shumë i vështirë dhe me një probabilitet të ulët saktësie për shkak të pasigurive që lidhen me:

- a) Shëmbuj të Shoqërive të ngjashme që ushtrojnë të njëjtin aktivitet dhe që kanë tregues të ngjashëm nuk kemi mundur të gjejmë që të kenë llogaritur "kthimin e lejuar të kapitalit" në kushtet e kapitalit të vet kaq negativ si ai që trashëgon OSHEE.
- b) Risku i biznesit në kushtet e fillimit të hapjes së tregut dhe humbjes së pozitës monopol të OSHEE është akoma hipotetik dhe nuk mund të matet.
- c) Dështimi i privatizimit tregoi një tendencë të fortë të pamundësisë së tërheqjes së kapitalit dhe OSHEE është akoma një shoqëri që mund të mbijetojë në treg falë mbështetjes së vazhdueshme të Qeverisë Shqiptare e cila ka përdorur shpesh garancinë sovranë për të shpërtuar financiarisht shoqërinë.

Në kushtet e pamundësisë për të studiuar metodologjikisht "Normën e Kthimit të Lejuar mbi Kapitalin" ju referuam nivelit të shprehur më parë në deklaratën rregullatore prej 16.44%, i cili është referenca më e mirë ku mund të referohemi. Norma e lartë e llogaritjes në Deklaratën Rregullatore e kryer për një investim të huaj ku risku i vendit ka qenë shumë i lartë mendojmë se kompenson pasiguritë e riskut të shtuar financiar në të cilin ndodhet OSHEE.

10. Në përllogaritjet tuja për përcaktimin e normës së interesit të borxhit përfshihet borxhi ndaj CEZ a.s. ndërkohë që në kostot për llogaritjen e tarifës së shërbimit universal është përfshirë komplet kësti që duhet të paguhet për vitin 2018 në rubrikën "kompensim për CEZ". Lutemi bëni korigjimet tuaja në llogaritje duke zbatuar kërkesat e metodologjive përkatëse për shërbimin e shpërndarjes dhe të furnizimit.



Në zbatim të Metodologjisë së Llogaritjes së Tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike neni 7 Kërkesa për të Ardhura për Vitin Bazë (Kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve) pika 12, borxhi ndaj CEZ a.s. do të shlyhet në Gusht 2018 dhe përderisa është një borxh i papaguar nuk ka përse të mos referohet për llogaritjen e kostos së kapitalit.

Për më tepër norma e interesit të borxhit në OSHEE i referohet borxhit të marrë nga Banka Botërore me interesa shumë të ulta që nuk përfaqsojnë normën e tregut në të cilin OSHEE ka hyrë tashmë. Si e tillë ajo shtrembëron koston e kapitalit në krahasim me shoqëri të ngjashme që tashmë janë prezente në tregun e energjisë. Përfshirja e borxhit ndaj CEZ shërben për të përafuar normën me normën e tregut dhe si e tillë nuk mund të mos merret parasysh.

11. Marzhi i fitimit prej 5% i aplikuar nga OSHEE sh.a. është në kundërshtim me dispozitën 6.f e "Metodologjisë për përcaktimin e cmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)" e cila përcakton një kufi prej 3% të marzhit të fitimit mbi kostot për blerjen e energjisë dhe kapacitetit. Të paraqiten rrillogaritjet në zbatim të metodologjisë.

Metodologjia për përcaktimin e cmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) e miratuar në 23.11.2017 ka mbërritur në OSHEE pasi u bënë përlllogaritjet dhe u dorëzuar aplikimi. Përlllogaritjet u bënë sipas propozimit tonë të mëparshëm që marzhi të ishte 5%. E ardhura e kërkuar për FSHU në kushtet e marzhit 3% llogaritet në tabelën më poshtë:

Zeri	2015	2016	2017	2018
<b>Shpenzime Operative</b>	<b>1,898,311</b>	<b>2,510,572</b>	<b>2,486,330</b>	<b>2,499,684</b>
Kosto e Energjisë së shitur nga FPSH (+Marzh)	13,378,333	13,815,794	19,421,534	16,841,325
Kosto e transmetimit	2,725,012	2,760,035	3,013,587	3,311,237
Marzhi	294,323	303,947	582,646	505,240
Kompensimi i Borxhit i Keq	3,709,373	3,857,845	1,252,715	3,169,725
Kompensim për humbjet 2012 - 2014 (CEZ)	3,051,308	2,894,742	2,787,638	2,818,842
<b>Totali i të Ardhurave të Kerkuara</b>	<b>25,056,659</b>	<b>26,142,935</b>	<b>29,544,451</b>	<b>29,146,053</b>
Energji e shitur në rrjetin e shpërndarjes MWH	4,459,444	4,605,265	4,789,590	4,803,209
<b>Tarifa mesatare e shitjes Lekë/KW</b>	<b>5.62</b>	<b>5.68</b>	<b>6.17</b>	<b>6.07</b>

12. Paraqisni informacion të detajuar dhe sqarimet përkatëse mbi mënyrën e llogaritjes së koeficienteve të propozuar të cilët janë përdorur për shpërndarjen e kostove në nivel tensioni të alokimit të të ardhurave të kerkuara sipas niveleve të tensionit.

Ristrukturimi i shoqërisë dhe kryerja e investimeve do të krijojë kushte për vlerësimin e qartë të kostove operative për njësi të aktivitetit të shoqërisë, përfshi edhe kostot për nivel tensioni. Në kushtet e mungesës së këtij informacioni kemi operuar me koeficientë të alokimit bazuar në:

- Ndarjen e kostove operative ndërmjet Shpërndarjes dhe Shitjes me peshe specifike respektive 79.24% për Operatorin e Shpërndarjes dhe 20.76% për Operatorin e Shitjes.
- Koeficientin që lidhet me peshën specifike të energjisë së shitur në nivel tensioni si në planifikuar për vitin 2018 në tabelën që vijon :

Niveli i Tensionit	2018	%
	KWH	
35 kV	57,532	1.20%
20 kV	259,653	5.41%
10 - 6 kV	646,577	13.46%
I ulët 0.4 kV	3,839,447	79.94%
<b>Total</b>	<b>4,803,209</b>	

Me këto koeficientë janë alokuar: a) vlera e Aseteve b) Amortizimi c) Të ardhura nga lidhjet e reja d) Të ardhura nga energjia reaktive.

c) Humbjet teknike për nivel tensioni si në tabelën më poshtë:

Humbjet Teknike	
Tensioni	Humbjet%
35kV	5.95%
20kV	2.31%
10-6 kV	8.64%
0.4 kV	10.05%
<b>Total</b>	<b>17.90%</b>

d) Koeficientin e ponderuar që merr parasysh koeficientin e peshës specifike të energjisë dhe humbjet teknike si në tabelën më poshtë:

Niveli i Tensionit	2018	%	Koeficienti i ponderuar i Humbjeve
	KWH		
35 kV	57,532	1.20%	0.76%
20 kV	259,653	5.41%	1.33%
10 - 6 kV	646,577	13.46%	12.38%
I ulët 0.4 kV	3,839,447	79.94%	85.53%
<b>Total</b>	<b>4,803,209</b>		<b>100.00%</b>

Me këtë koeficient janë alokuar: a) Shpenzimet Operative b) Shpenzimet e humbjeve të energjisë c) Shpenzimet e transmetimit.

13. Kërkohe shtesë informacioni dhe argument në përputhje me pikën 5.17 të metodologjisë së llogaritjes së tarifave për operatorin e sistemit të shpërndarjes: "Në përgatitjen e aplikimit për tarifa OSSH do të perpiqet të paraqesë gjithë kostot me saktësi deri në 100,000 Lekë".

Në studimin e tarifës janë marrë parasysh të gjitha kostot historike me saktësi të plotë, si dhe kostot e planifikuara. Ju lutem sqaroni se çfarë nënkupton termi "gjithë kostot": a) Kostot klasifikuar



sipas natyrës b) Kostot klasifikuar sipas destinacionit c) Transaksionet per cdo furnitor d) Tjetër klasifikim që ju mendoni.

Me konsideratë,

**Adrian ÇELA**  
**Administrator**

**OSHEE sh.a.**

